



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:241238
Datë: 18.11.2024
Numri i dokumentit: 06470297

Ac.nr.8667/22

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ylber Shurdhiqi, kryetar i kolegjit, Hunaida Pasuli dhe Ardian Ajvazi, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësve M. K., M. K., D. K., E. S. dhe L. S., nga Deçani të cilët në bazë të autorizimit i përfaqëson I. S., avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Illyria”, me seli në Prishtinë, për shkak të kompensimit të dëmit material dhe jo material, duke vendosur në lidhje me ankesën e të paditurës të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.825/2015, të datës 13.10.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 14.11.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve “Illyria”, me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.825/2015, i datës 13.10.2022, në pikën I të dispozitivit, që ka të bëjë me pjesën aprovuese të kërkesëpadisë së paditësve M. K., M. K., D. K., E.S. dhe L. S., nga Deçani, si dhe në pikën III të dispozitivit që ka të bëjë me shpenzimet e procedurës, VËRTETOHET.

II. Pikat II e dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar të Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.825/2015, i datës 13.10.2022, që ka të bëjë me pjesën refuzuese të kërkesëpadisë së paditësve, mbeten të pashqyrtuara.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.825/2015, të datës 13.10.2022, ka vendosur si në vijim: I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadija e paditësve M. K., M. K., D. K., E. S., L.S. nga Deçani dhe DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve “Illyria”, me seli në Prishtinë, që paditëseve në emër të kompensimit të demit, t’ia paguaj shumat si vijon:

- 1.1.** Paditësit M. K. në emër të dëmit jo material dhe material, shumën e përgjithshme prej 3.656 Euro, e cila shumë përfshin kompensimin si në vijim:
- për dhimbje fizike shumën prej 1.900 €

- për frikën e përjetuar shumë prej 1.400 €
- për ushqim të përforcuar shumë prej 150 €
- për ndihmën e personit të tretë shumë prej 200 €
- për shpenzimet e mjekimit shumë prej 6 €

1.2. Padi tëses M. K. në emër të dëmit material dhe jo material shumë e përgjithshme prej 3.662 Euro, e cila shumë përfshin kompensimin si në vijim:

- për dhimbje fizike shumë prej 1.900 €
- për frikën e përjetuar shumë prej 1.400 €
- për ushqim të përforcuar shumë prej 150 €
- për ndihmën e personit të tretë shumë prej 200 €
- për shpenzimet e mjekimit shumë prej 12 €

1.3 . Padi tësit D.K. në emër të dëmit material dhe jo material shumë e përgjithshme prej 3.190 Euro, e cila shumë përfshin kompensimin si në vijim:

- për dhimbje fizike shumë prej 1.700€
- për frikën e përjetuar shumë prej 1.200 €
- për ushqim të përforcuar shumë prej 150 €
- për ndihmën e personit të tretë shumë prej 140 €

1.4 Padi tësit E. S. në emër të dëmit material dhe jo material shumë e përgjithshme prej 3.150 Euro, e cila shumë përfshin kompensimin si në vijim:

- për dhimbjen fizike shumen prej 1.700 €
- për frikën e përjetuar shumë prej 1.200 €
- për ushqim të përforcuar shumë prej 150 €
- për ndihmën e personit të tretë shumë prej 100 €

1.5 . Padi tëses Leon Sejfiqaj në emër të dëmit material dhe jo material shumë e përgjithshme prej 3.150 Euro, e cila shumë përfshin kompensimin si në vijim:

- për dhimbjen fizike shumë prej 1.700 €
- për frikën e përjetuar në shumë prej 1.200 €
- për ushqim të përforcuar shumë prej 150 €
- për ndihmën e personit të tretë shumë prej 100 €

Ashtu që shuma e tërësishme e arrin vlerën prej 16.808 €, me kamat ligjore prej 8 %, e cila fillon të rrjedh nga dita e marrjes së aktgjykimit e deri në përmbushjen definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi.

II. REFUZOHET si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë mbi shumat e gjykuara, dhe atë : për padi tësin M.K.në emër të dëmit jo material, për dhimbje fizike nga shuma e aprovuar prej 1.900€ e deri në shumë e kërkuar prej 3.500€, për frikën e përjetuar nga shuma prej 1.400€ deri në shumë e kërkuar prej 1.700, për ushqimin e përforcuar nga shuma e aprovuar prej 150€ deri në shumë e kërkuar prej 400€, për shpenzimet e mjekimit nga shuma e aprovuar prej 6 € deri në shumë e kërkuar prej 100€,si dhe shuma e tërësishme prej 230€ e kërkuar në emër të

rehabilitimit mjekësor. Për paditësen M. K. në emër të dëmit jo material, për dhimbje fizike nga shuma e aprovuar prej 1.900€ e deri në shumën e kërkuar prej 3.500€, për frikën e përjetuar nga shuma prej 1.400€ deri në shumën e kërkuar prej 1.700, për ushqimin e përforcuar nga shuma e aprovuar prej 150€ deri në shumën e kërkuar prej 400€, për shpenzimet e mjekimit nga shuma e aprovuar prej 12 € deri në shumën e kërkuar prej 100 €, si dhe shuma e tërësishme prej 230€ e kërkuar në emër të rehabilitimit mjekësor. Për paditësin D. K. në emër të dëmit jo material, për dhimbje fizike nga shuma e aprovuar prej 1.700€ e deri në shumën e kërkuar prej 3.500€, për frikën e përjetuar nga shuma prej 1.200€ deri në shumën e kërkuar prej 1.700, për ushqimin e përforcuar nga shuma e aprovuar prej 150€ deri në shumën e kërkuar prej 400€, për ndihmën e personit të tretë nga shuma e aprovuar prej 140 € deri në shumën e kërkuar prej 200 €, për shpenzimet e mjekimit nga shuma e tërësishme prej 100 €, si dhe shuma e tërësishme prej 230€ e kërkuar në emër të rehabilitimit mjekësor. Për paditësin E.S. në emër të dëmit jo material, për dhimbje fizike nga shuma e aprovuar prej 1.700€ e deri në shumën e kërkuar prej 3.500€, për frikën e përjetuar nga shuma prej 1.200€ deri në shumën e kërkuar prej 1.700 €, për ushqimin e përforcuar nga shuma e aprovuar prej 150€ deri në shumën e kërkuar prej 400€, për ndihmën e personit të tretë nga shuma e aprovuar prej 100 € deri në shumën e kërkuar prej 200 €, për shpenzimet e mjekimit shumen e tërësishme prej 100 €, si dhe shuma e tërësishme prej 230€ e kërkuar në emër të rehabilitimit mjekësor, Për paditësin L. S. në emër të dëmit jo material, për dhimbje fizike nga shuma e aprovuar prej 1.700€ e deri në shumën e kërkuar prej 3.500€, për frikën e përjetuar nga shuma prej 1.200€ deri në shumën e kërkuar prej 1.700, për ushqimin e përforcuar nga shuma e aprovuar prej 150€ deri në shumën e kërkuar prej 400€, për ndihmën e personit të tretë nga shuma e aprovuar prej 100 € deri në shumën e kërkuar prej 200 €, për shpenzimet e mjekimit shumen e tërësishme prej 100 €, si dhe shuma e tërësishme prej 230€ e kërkuar në emër të rehabilitimit mjekësor,

III. OBLIGOHET e paditura që paditëseve t'ia kompensojë shpenzimet e procedurës në shumë prej 2.472 €.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë e paditura, për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me të cilën i ka propozuar Gjykatës që të aprovohet ankesa e të paditurës dhe të ndryshohet vendimi i atakuar lidhur me lartësinë e kërkesëpadisë për të gjitha format e dëmit jo material.

Paditësit nuk kanë parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit e Kosovës pasi që i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre, në kuptim të neneve 194 dhe 195.1, pika (d), lidhur me nenin 200, të Ligjit për Procedurën Kontestimore dhe gjeti se:

- Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësit me kërkesëpadinë e precizuar kanë kërkuar që të detyrohet e paditura që në emër të dëmit material dhe jo material të shkaktuar nga aksidenti i komunikacionit i datës 10.08.2014, sipas bazës së auto përgjegjësisë, paditësve t'ia paguaj shumë

në lartësi të përgjithshme prej 33.150.00 €, me kamatë prej 8% duke filluar nga dita e paraqitjes së padisë deri në pagesën definitive, krejt këto në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të aktgjykimit nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

Duke vepruar sipas padisë së paditësve, gjykata e shkallës së parë ka zhvilluar procedurën gjyqësore, dhe ka administruar provat, ndërsa pas vlerësimit të provave të administruara ka vendosur sikurse në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, mes tjerash, ka theksuar se mes palëve ndërgjyqëse nuk ka qenë kontestuese baza juridike e kërkesëpadisë. Sa i përket lartësisë së kërkesëpadisë gjykata ka nxjerrë një ekspertizë mjekësore nga ekspertët Dr. N. D. dhe Dr. V. B. mendimin e të cilëve e konsideron të pakontestueshëm, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 173 par. 2 dhe 183 të LMD-së. Ndërsa lidhur me shpenzimet procedurale, gjykata ka vendosur konform nenet 449 dhe 452 të LPK-së (*më gjerësisht sikurse në arsyetim të aktgjykimit të atakuar*).

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjukata e Apelit vlerëson së qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) i LPK-së dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjukata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu ky aktgjykim nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Gjukata e Apelit e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, për sa i përket vërtetimit të bazës juridike të kërkesëpadisë së paditësve, e meqë as në ankesë nuk ka ndonjë pretendim ankimor që do të mund të ndryshonte qëndrimin lidhur me këtë, Gjukata e Apelit e vërteton si të drejtë vendimin e gjykatës së shkallës së parë në lidhje me bazën juridike të kërkesëpadisë dhe nuk e sheh të arsyeshme që të lëshohet më tutje në trajtimin e kësaj pjese.

Në anën tjetër, nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të palës së paditur për shkeljet që i referohen zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, ngase gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur sa i përket lartësisë së kërkesëpadisë, vendim të cilin Gjukata e Apelit e ka vërtetuar po ashtu edhe shumat e kompensimit, të gjykuara nga gjykata e shkallës së parë. Si rrjedhojë e kësaj, është vendosur që aktgjykimi i atakuar në pikën I të dispozitivit të vërtetohet, e të refuzohet si e pathemeltë ankesa e palës së paditur, sipas të cilës, shumat e kompensimit do të duhej të uleshin, për të përmbushur qëllimin e satisfacionit adekuat material për palët e dëmtuara. Sipas vlerësimit të Gjukatës së Apelit, duke marrë parasysh natyrën e lëndimeve (të lehta trupore), si dhe kohëzgjatjen e dhimbjeve dhe frikës, të konstatuara në ekspertizën mjekësore të hartuar nga Dr. N. D. dhe Dr. V. B., të datës 19.07.2022, është vendosur që të vërtetohen shumat e kompensimit në emër të dëmit jo material dhe material të shkaktuar në aksidentin e komunikacionit të datës 10.08.2014, në magjistralen Gjakovë-Deçan, në fshatin P.. Gjatë vendosjes lidhur me to, gjykata e shkallës së parë, është mbështetur siç duhet në nenin 183 parag.2 të LMD-së, i cili decidivisht thotë se: “Me rastin e vendosjes për kërkesën mbi

kompensimin e dëmit jo material si dhe mbi shumën e kompensimit të tij, gjykata do të ketë parasysh për rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe të qëllimit të cilit shërben ky kompensim e gjithashtu edhe për faktin se mos të u shkojë përshtat synimeve që nuk janë të pajtueshme me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror“. Nga interpretimi i kësaj dispozite ligjore, rezulton se kompensimi duhet të jetë adekuat me natyrën e lëndimit, intensitetin dhe kohëzgjatjen e dhimbjeve të përjetuara, si dhe frikës së palës së dëmtuar, ashtu që kompensimi të përfaqësojë një lehtësim në përballimin dhe tejkalimin e pasojave të dëmit që në këtë rast pala paditëse ka pësuar në aksidentin e ndodhur, e që në të njëjtën kohë, ato të jenë reale dhe të paraqesin satisfakcion të vërtetë, për aq sa është e mundur, duke u shkuar për shtati synimeve shoqërore për kompensimin e dëmit. Në kuptim të kësaj, konstatohet se gjykata e shkallës së parë ka vepruar konform një dispozite të tillë. Ndërsa, sa i përket shumës së kompensimit të dëmit material për ndihmë dhe kujdes së personit të tretë dhe ushqim të përforcuar, e cila po ashtu është vërtetuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, Gjykata e Apelit konsideron se kompensimi i tyre, i caktuar nga gjykata e shkallës së parë, është i drejtë dhe i ligjshëm. Kjo, pasi që forma të tilla të dëmit, është e vështirë, e pothuajse e pamundur, që të vërtetohen me prova konkrete, por praktika e Gjykatave të Kosovës, njeh forma të tilla të kompensimit, sa herë që konstatohet nevoja për to. Kështu, meqë në këtë rast, në ekspertizë mjekësore është konstatuar se palët e dëmtuara kanë pasur nevojë për ushqim të përforcuar dhe ndihm nga presoni i tretë, atëherë vërtetohet se të dëmtuarve i’u takon e drejta në kompensim për këto forma të dëmit, në lartësinë e gjykuar nga gjykata e shkallës së parë, për të cilën edhe pala e paditur nuk ka pasur ndonjë pretendim ankimorë.

Më tutje, gjykata e shkallës së parë e ka vërtetuar edhe vendimin e gjykatës së shkallës së parë lidhur kamatën e gjykuar, pasi që e njëjta është në përputhje me dispozitën e nenin 382 të LMD-së së vitit 2012, si ligj i zbatueshëm në rastin konkret. Gjithashtu është vërtetuar edhe vendimi mbi shpenzimet procedurale, andaj refuzohen si të paqëndrueshme edhe pretendimet ankimore kundrejt tij.

Gjykata e shkallës së parë, me të drejtë është bazuar në nenin 452 të LPK-së, përkatësisht, paragrafin 2 të tij, që decidivisht thotë se: *“Po që se paditësi vetëm pjesërisht ka sukses në procesin gjyqësor, atëherë gjykata mundet, duke marrë parasysh suksesin e arritur, të caktojë që secila palë t’i bartë shpenzimet e veta apo që njëra palë t’ia shpërblej tjetrës, dhe ndërhyrësit që i është bashkuar, pjesën proporcionale të shpenzimeve”*. Sipas kësaj dispozite, është në diskrecionin e gjykatës që të vendosë nëse secila palë do t’i bartë shpenzimet e veta apo njëra do t’ia shpërblejë shpenzimet tjetrës, edhe atëherë kur njëra palë ka pasur pjesërisht sukses në kontest, si në këtë rast.

Gjykata e Apelit vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi që ka rezultuar se nuk ka pasur pretendime ankimore nga asnjëra palë ndërgjyqëse në raport me vendosjen e gjykatës së shkallës së parë për pikat II të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar, që ka të bëjë me pjesën refuzuese të kërkesëpadisë së paditësve, andaj kjo pjesë e dispozitivit të aktgjykimit konform nenit 194 të LPK-së, ka mbetur e pashqyrtuara. Gjykata e Apelit, me rastin e vendosjes, shqyrtoi edhe të gjitha pretendimet tjera ankimore të palës së paditur, por të njëjtat nuk patën ndikim relevant në vendosjen ndryshe në këtë çështje juridike.

Nga të gjitha arsyet e cekura në arsyetim të këtij aktgjykimi të shkallës së dytë, Gjykatës së Apelit i rezulton se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, andaj në mbështetje të dispozitave nga nenet 194 dhe 195, paragrafi 1, pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.8667/2022 me dt.14.11.2024

Kryetari i kolegjit, Gjyqtari,
Ylber Shurdhiqi